



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
 Dep. _____
 Nr. Itaq. _____
 Nr. pages _____

Nr. Prot. _____
 Br. Prot. _____
 Prot No. 03-03/260/18
 Data _____
 Datum 29-01-2018
 PRISHTINE

DATE/A:	29.01.2018
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	z. Faredin SYLEJMANI Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit në Spitali i Përgjithshëm Gjilan
CC:	z. Dr. Agim KRYEZIU U.D Drejtor Ekzekutiv
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin me titull: <i>"Përgatitja e ushqimit për pacient dhe stafin mjekësor kujdestar"</i> , me numër prokurimi: 220-70001-0731-17-5254-211.

I nderuari z. Sylejmani,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin *"Përgatitja e ushqimit për pacient dhe stafin mjekësor kujdestar"* me numër prokurimi: 220-70001-0731-17-5254-211, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve ligjore të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: *“Përgatitja e ushqimit për pacient dhe stafin mjekësor kujdestar” me numër prokurimi: 220-70001-0731-17-5254-211*, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

A r s y e t i m i

Agjencia Kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare përmes kërkesës të datës 10/01/2018, me numër protokolli 03-03/4918/17, iu është drejtuar Autoritetit Kontraktues Spitalit Përgjithshëm Gjilan, duke kërkuar tërë dokumentacionin në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: *“Përgatitja e ushqimit për pacient dhe stafin mjekësor kujdestar” me numër prokurimi: 220-70001-0731-17-5254-211*.

Autoriteti Kontraktues Spitali i Përgjithshëm Gjilan, më datë 24 nëntor 2017, ka publikuar ne web faqen e KRPP-së, njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: *“Përgatitja e ushqimit për pacient dhe stafin mjekësor kujdestar”* në procedurë të hapur, kontratë për furnizim, me vlerë të madhe.

Agjencia kundër Korrupsionit pas analizimit të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, ka vërejtur se vlera e parashikuar e kësaj kontrate është 480,000.00 €, ndërsa në nenin 9.1 lidhur me nenin 9.2 të FTD-së, te kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale autoriteti kontraktues ka specifikuar kërkesën: Lista e kontratave të realizuara ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses tri kontrata dhe tri referenca për të njëjtat kontrata në vlerën prej 800,000.00€, në tri vitet e fundit (2014, 2015, 2016).

Autoriteti Kontraktues Spitali i Përgjithshëm Gjilan, më datë 17.01.2018, iu është përgjigjur kërkesës së Agjencisë duke ofruar në dispozicion tërë dokumentacionin e kërkuar.

Andaj Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka trajtuar dhe analizuar me kujdes tërë dokumentacionin në dispozicion për këtë aktivitet të prokurimit ka konstatuar faktet si në vijim:

KA B
NËR
OPTIO

TIV KO
HATJE

Me dt. 15.12.2017, operatori ekonomik i interesuar për të tenderuar në aktivitetin e prokurimit me titull: *“Përgatitja e ushqimit për pacient dhe stafin mjekësor kujdestar”*, ka bërë vërejtje në dosjen e tenderit, ku thuhet: kemi hasur ne disa pika të cilat janë pa sqarime adekuate apo me gabime: *Vlera e parashikuar $480,000.00 \times 1.5 = 720,000.00$ (ju referenca keni kërkuar ne vlere prej 800,000.00 ero).* Po ashtu, me dt. 17.12. 2017, një operator tjetër ekonomik i interesuar për të tenderuar në aktivitetin e prokurimit me titull: *“Përgatitja e ushqimit për pacient dhe stafin mjekësor kujdestar”*, ka parashtruar pranë autoritetit kontraktues përmes shkresës elektronike-emalit, kërkesë për informacion shtesë ku thuhet: Kërkesa për qarkullim dhe referenca është në kundërshtim me nenin 68.1 të LPP-së.

Pas analizimit të fakteve të lartë cekura Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se kërkesa e specifikuar në nenin 9.1 lidhur me nenin 9.2 në FTD, është në kundërshtim me nenin 68 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, si dhe me nenin 26 paragrafi 8 pika 4 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimi Publik, ku thuhet: *Kur përveç qarkullimit minimal, është i nevojshëm një qarkullim i caktuar minimal në fushën specifike të mbuluar nga kontrata, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë kufizimin ligjor një pikë pesë (1.5) herë vlerën e parashikuar të kontratës.*

Ndërsa një fakt tjetër që është evidentuar gjatë trajtimit të dokumentacionit në fjalë është se autoriteti kontraktues Spitali i Përgjithshëm Gjilan, nuk ka respektuar nenin 53 paragrafi 6 të LPP-së, për faktin se përgjigjen lidhur me kërkesën për informacione shtesë të parashtruar nga operatorët ekonomik ku thuhet se: *Në dosjen e tenderit nuk është i specifikuar numri i shujtave andaj kërkojmë informacione shtesë për menytë e përdorura në mëngjes, drek dhe darkë dhe këto sqarime zyrtari përgjegjës i prokurimit u ka dërguar vetëm operatorëve ekonomik që kanë parashtruar kërkesë për informata sqarues përmes shkresës elektronike e-mailit, duke mos respektuar nenin e lartë cekur ku thuhet: *autoriteti kontraktues është i obliguar që menjëherë dhe në të njëjtën kohë t'i siguron informata me shkrim, të gjithë operatorëve ekonomik, që kanë marrë ose kanë pranuar nga autoriteti kontraktues dosjen e tenderit përkatës.**

Me tutje gjatë trajtimit të dokumentacionit në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, Agjencia ka konstatuar se dosjen e tenderit respektivisht Pjesa II-Përshkrimi i çmimeve, autoriteti kontraktues të përshkrimi i çmimit ka specifikuar njësia matëse racion, sasia 1, andaj bazuar në faktin se kjo kontratë është kontratë publike kornizë, Agjencia konsideron se në rastin konkret autoriteti kontraktues me rastin e mos specifikimit të sasisë së përafërt në dosje të tenderit, nuk ka respektuar nenin 18.27 të Rregullat dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik ku thuhet: *Në*

rast të aplikimit të kontratës kornizë ku sasitë mund të mos jenë parashikuar në mënyrë precize një parashikimi i përafërt i sasive duhet të përfshihet.

Hapja e ofertave për këtë tender është bërë me dt. 04.01.2018, dhe procesi i vlerësimit të ofertave është bërë me dt. 12.01.2018, andaj këtu shihet se autoriteti kontraktues respektivisht zyrtari përgjegjës i prokurimit procesin e vlerësimit të ofertave e ka filluar tetë (8) ditë pas procesit të hapjes së ofertave, që është në kundërshtim me nenin 41.2 të Rregullat dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, ku thuhet: *Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se 5 dite pas përfundimit të procesit të hapjes.*

Me datën 10.01.2018, zyrtaret përgjegjëse të AKK-së kanë qënë në zyrën e prokurimit për të sqaruar ndryshimet të cilat janë deklaruar se janë bërë në platformë lidhur me kërkesat mbi aftësitë teknike dhe profesionale si dhe mundësinë e vlerësimit të këtij tenderi. Si rrjedhojë e kësaj Autoriteti kontraktues përmes shkresës elektronike e-malit, të dt.10 janar 2018, e njofton Agjencinë ku thuhet: jemi në pritje të interpretimit ligjor nga KRPP-ja, lidhur me situatën e krijuar për mos përfshirje të ndryshimit të një kriteri në dosjen e tenderit në gjuhën shqipe nga sistemi elektronik për tenderin me titull: “Përgatitja e ushqimit për pacient dhe stafin mjekësor kujdestar”, posa të marrim përgjigjen nga KRPP do ta ftojme AKK-në, për pjesëmarrje në vlerësim të këtij aktivitetit të prokurimit.

Agjencia bazuar në dokumentacionin që ka në trajtim sqaron se autoriteti kontraktues nuk ka ofruar ndonjë provë që argumenton se ka dërguar kërkesë për interpretim ligjor në KRPP apo ka pranuar interpretim nga KRPP-ja, lidhur me shkresën e dt. 10 janar 2018. Përveç kësaj Autoriteti Kontraktuar ka përfunduar procesin e vlerësimit të ofertave pa pjesëmarrjen e Agjencisë edhe për kundër faktit që ishim në pritje të konfirmimit për pjesëmarrje në vlerësim të ofertave.

Kështu që, me dt. 17.01.2018, në Agjenci përveç dokumentacionit të kërkuar A.K ka sjellë edhe raportin e vlerësimit për këtë tenderë në të cilin raport shihet se komisionin i vlerësimit kërkesën nr. 4, të kërkesa mbi aftësitë teknike dhe profesionale, ofertat e operatorëve ekonomik që kanë ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit i ka vlerësuar në bazë kriterit të specifikuar në dosjen e tenderit në gjuhën shqipe, ku është kërkuar: *Operatori duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses tri kontrata dhe referenca për të njëjtat kontrata në vlerë prej 800,000.00 euro, në tri vitet e fundit (2014, 2015, 2016).* Ndërsa, në raportin e brendshëm të autoritetit kontraktues, e njëjta kërkesë nga komisioni i vlerësimit është vlerësuar në bazë të kriterit: *Lista e projekteve të*

realizuar ne tri vitet e fundit 2014, 2015, 2016, minimum tri referenca për të njëjtat kontrata vlera në total 720,000.00 euro.

Agjencia kundër Korrupsionit, me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike lidhur për mos përfshirje së ndryshimit të kriterit në dosjen e tenderit në nenin 9.1 lidhur me nenin 9.2 të FTD-së për kriterin nr. 4, në gjuhën shqipe nga platforma elektronike, ka verifikuar në E-prokurimi – Përmbledhja e Prokurimit, dhe ka vërejtura që autoriteti kontraktues Spitali i Përgjithshëm Gjilan në sistem ka ngarkuar njoftimin për kontratë, dt. 27.11.2017, dhe dosjen e tenderit për aktivitetin e prokurimit me titull: *“Përgatitja e ushqimit për pacient dhe stafin mjekësor kujdestar” me numër prokurimi: 220-70001-0731-17-5254-211*, që rezulton se zyrtari i prokurimit nuk ka ngarkuar ndonjë dokument tjetër, edhe pse ka pasur kërkesë për informacione shtesë nga operatorët ekonomik lidhur me kërkesën e dosjen e tenderit në nenin 9.1 lidhur me nenin 9.2 të FTD-së për kriterin nr. 4.

Agjencia kundër Korrupsionit, konsideron se autoriteti kontraktues në procesin e aktivitetit të prokurimit me titull: *“Përgatitja e ushqimit për pacient dhe stafin mjekësor kujdestar” me numër prokurimi: 220-70001-0731-17-5254-211*, nuk ka respektuar nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi, nenin 27 Dosja e tenderit, nenin 53 paragrafi 6 Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit, nenin 68 Gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenin 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale i Ligjit Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe nenin 18. 17, nenin 26 paragrafi 8 pika 4, nenin 41.2 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimi Publik.

Agjencia pas trajtimit të dokumentacionit për tenderin me titull: *“Përgatitja e ushqimit për pacient dhe stafin mjekësor kujdestar”*, ju njofton me të gjeturat e aktivitetit të prokurimit në tenderin *“Përgatitja e ushqimit për pacient dhe stafin mjekësor kujdestar” me numër prokurimi: 220-70001-0731-17-5254-211*, dhe rekomandon që të veproni sipas dispozitave ligjore të Prokurimit Publik për situatat e tilla duke marr parasysh që të gjeturat ua dërgojmë në shqyrtim dhe vendosje. Po ashtu ju njoftojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !